

LIRIA DHE TOLERANCA



**ELEMENTE KRYESORE
TË DEMOKRACISË**

NJOHURITË MBI DEMOKRACINË

QAMILE (13), ARBONA (13), ERZA (13), ERISA (13), ENES (13), AMMAR (13), JON (13)



Karakteristikat e demokracisë dhe llojet e saj

Të respektosh tjetrin është e rëndësishme. Si dhe toleranca duhet të jetë në nivel.

Këto fjali që i përmendëm më herët, kanë të bëjnë me demokracinë. Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë udhëheqje. Llojet e demokracisë janë: demokracia përfaqësuese dhe demokracia e drejtëpërdrejtë. Në demokracinë përfaqësuese hyjnë dy sisteme: sistemi presidencial dhe sistemi parlamentar. Demokracia presidenciale është ajo demokraci në të cilën populli e zgjedh udhëheqësin apo Presidentin në mënyrë direkte me anë të votave, kurse ajo përfaqësuese është kur qytetarët zgjedhin përfaqësues që quhen deputetë, të cilët mundohen t'i përmbushin kërkesat e qytetarëve.

QYTETARËT

Qytetarët janë pjesëtarë të një vendi të cilët kanë leje qëndrimi në atë vend. Në këtë grup bëjnë pjesë veprimet e qytetarëve aktiv të cilat bëjnë aktivitete të ndryshme dhe kryejnë obligimin e votës.

Qytetarët duhet të jenë tolerant, që do të thotë të kenë respekt ose mirëkuptim ndaj njëri-tjetrit, kurse liri është që të mos shkelen të drejtat e tua dhe që të jesh i lirë të lëvizësh, të veprosh dhe të trajtohesh në të njëjtën mënyrë si gjithë të tjerët. Ndërsa, me barazi kuptojmë respektimin ose barazinë ndaj njëri-tjetrit duke mos bërë dallime.

PËRGJEGJËSITË TONA

Përgjegjësitë janë obligimet tona të cilat ne si qytetarë aktiv duhet t'i kryejmë.

Përgjegjësitë tona janë: respektimi i të moshuarve, bashkëpunimi me njëri-tjetrin, respektimi i rregullave, mbrojtja e vendit, ruajtja e ambientit, vota e lirë, etj.

TË DREJTAT TONA

E drejtë parësore është e drejta për jetesë.

Përveç kësaj, ne si qytetarë të Republikës së Kosovës kemi të drejta të shumta dhe ato janë: e drejta e lirisë, e drejta e shkollimit, e drejta e strehimit, e drejta e familjes, e drejta e punës, e drejta civile dhe politike, e drejta sociale dhe ekonomike, etj.



Autorët e artikullit duke bashkëpunuar

NDARJA E PUSHTETIT

LINDRIT (13), ERLISI (13), BARDH (14), OLTİ (13), ANESA (13), AULONA (13), LISA (13)




Ndarja e pushtetit dhe mendimet tona për këtë ndarje

Ndarja e pushtetit hynë në kuadër të demokracisë. Tri degët e pushtetit janë: Pushteti Gjyqësor, Pushteti Legjislativ, Pushteti Ekzekutiv. Në Pushtetin Legjislativ bën pjesë Kuvendi, i cili bënë propozimin dhe miratimin e ligjeve. Në Kuvend bëjnë pjesë deputetët të cilët zgjedhen drejtpërdrejt nga populli. Në Pushtetin Ekzekutiv bën pjesë Qeveria dhe detyra kryesore e saj është ekzekutimi i ligjeve, po ashtu Qeveria ka të drejtën të paraqes edhe projektligje. Në Qeveri bëjnë pjesë: Kryeministri, ministrat dhe zëvendëskryeministrat. Dega e tretë e pushtetit është Pushteti Gjyqësor i cili përbëhet nga gjykatat. Roli i gjykatave është vendosja e drejtësisë së vendit. Dallojmë tri lloje të gjykatave të cilat janë: Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Themelore. Gjykata Supreme është autoriteti më i lartë gjyqësor në Kosovë.

Ndarja e pushtetit është bërë në këtë mënyrë, sepse në këtë formë qeverisja e një vendi është më e lehtë. Këto pushtete duhet ta zbatojnë një ndër parimet kryesore të demokracisë, e që është barazia. Pra, secila degë e pushtetit duhet t'i trajtojë të gjithë në mënyrë të barabartë pa dallim feje, gjnie, race, moshe, etj. Të gjitha ligjet që nxirren në Kuvend na ndikojnë neve, për shembull ligjet të cilat nxirren për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, për Shëndetësi etj. Prandaj ne si popull duhet të kemi kujdes të veçantë se kë do ta zgje-

dhim si përfaqësuesin e vendit tonë. Edhe ne nxënësit duhet që të kemi parasysh se edhe ne në një farë forme mund të kontribuojmë në demokracinë e vendit tonë. Ky kontributi ynë vihet në pah duke qenë aktiv në shtetin tonë, duke respektuar mendimin e të tjerëve, duke marrur iniciativa të mira për një të ardhme sa më të mirë. Ne nxënësit jemi ata që e forcojmë demokracinë e vendit tonë, dhe për këtë arsye duhet te jemi qytetarë të denjë për shtetin tonë.



Demokratët e rinjë

SHTËPIA E LIGJEVE

AGON (13), REART (13), DENILDA (13), KORAB (13), ALBANA (13), RINESA (13), GENTRIT (14)



Nxënësit e sh.f.m.u „MODEL“ flasin për Kuvendin e Kosovës

Sot me datën 8 nëntor, ne nxënësit e shkollës „MODEL“ shprehëm mendimet tona për Kuvendin e Kosovës. Ne së pari biseduam për demokracinë, nga rrjedh ajo dhe si funksionon në Kosovë. Kosova si shtet demokratik udhëhiqet nga qytetarët e saj. Pastaj, për gjatë diskutimit tonë ne kuptuam se Kosova ka demokraci përfaqësuese. Kjo nënkupton se qytetarët e Kosovës votojnë përfaqësuesit e saj. Këta përfaqësues quhen deputetë. Për t'u bërë një deputet i Kuvendit të Kosovës duhesh të jesh kandidat që populli të të votojë ty. Ti mund të bëhesh përfaqësues i Kuvendit të Kosovës. Në rast se njëra parti merr shumicën e votave kalon në pozitë, kurse partitë e tjera kalojnë në opozitë. Deputetët së bashku zgjedhin Kryetarin e Kuvendit. Në Kuvendin e Kosovës ka vende për 120

deputetë. Shumica prej 100 deputetëve janë qytetarë të etnicitetit kosovar, ndërsa 20 të tjerë janë të komuniteteve jo shumicë si komuniteti romë, ashkali, serb, egjiptian, turk, etj. Kuvendi i Kosovës ka tri funksione kryesore. Ato janë funksioni përfaqësues, funksioni kontrollues dhe funksioni ligjvënës.

Kuvendi i Kosovës na përfaqëson neve qytetarëve, e kontrollon Qeverinë nëse ajo po e bën punën e vet siç duhet dhe i miraton ligjet.

Ligjet e miratuara barten në Qeveri dhe pastaj ekzekutohen. Qeveria dhe Kuvendi duhet të kenë një balancë në mes vete. Sa i përket Qeverisë ajo përbëhet nga Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat.

Nga diskutimi që patëm, ne u pajtuam se Kosovës në të ardhmen do t'i u duhen deputetë sa më të mirë në mënyrë që Kosova të integrohet në Evropë, të ketë politikë të shëndetshme dhe ne të jetojmë të lumtur.



Grupi gjatë punës



Anëtarët e grupit që diskutuan për Kuvendin e Kosovës

SIMULIM I ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE

ARTIN (13), ADNIT (13), ERIS (13), ELIONA (13), NORA (12), MELISA (13)

Ne sot kemi bërë simulim të zgjedhjeve parlamentare ku kandiduan gjithësej 6 parti politike dhe mandatin për të përfaqësuar popullin për 4 vjet e fitoi Partia ...

Siç e dimë, e drejta për të zgjedhur apo njohur ndryshe si e drejta e votës është e drejtë qenësore, që e gëzon secili individ. Por, të drejtën për të zgjedhur ose për t'u zgjedhur e kemi pasi që të arrijmë moshën 18 vjeçare, sepse jemi më të pjekur personalisht. Në Kosovë, si në disa vende tjera të demokracisë bashkëkohore, e drejta për të votuar nuk është e obligueshme, që do të thotë që në rast se ndonjë qytetar nuk dëshiron të votojë, ai ka të drejtë të mos votojë. Kosova edhe pse ka vetëm një qendër zgjedhore, ka dy lloje të zgjedhjeve, zgjedhje komunale (ku zgjedhen asambleistët dhe kryetari i komunës), si dhe zgjedhjet parlamentare (ku qytetarët i zgjedhin deputetët). Siç e cekëm më lart, ne sot kemi bërë simulim të zg-

jedhjeve parlamentare. Gjithësej në kandidim ishim 6 parti, secila parti kishte planprogramin e vet, të cilat i kemi prezantuar para masës dhe jemi munduar t'i bindim që të na votojnë. Pasi që secila parti e përfundoi prezantimin lidhur me planprogramin e vet, filluam të votojmë për partinë që na ka pëlqyer dhe ka arritur të na bindë. Partia e cila fitoi besimin e masës ishte „Super Partia e Kosovës (SPK)“, që premtoi ndryshime ekonomike dhe mundësi për punësim. Kjo parti ka mandat 4 vjeçar dhe një nga detyrat kryesore të saj është ta përfaqësojë popullin që sot e ka votuar. Kjo që paraqitëm ishte vetëm një simulim i zgjedhjeve parlamentare, pasi që ne nuk e kemi të drejtën e votës deri në moshën 18 vjeçare.


PARTITË DUKE SHPALOSUR PLANPROGRAMIN E TYRE




Eliona dhe Erisi



Artini dhe Melisa



Nora dhe Adniti



Adniti



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „MODEL“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë